V E N D I M
Nr. 53, datë 28.9.1999

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i ""
Hajredin Fuga,	Anëtar i ""
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Sokol Sadushi,	Anëtar i ""
Kujtim Puto,	Anëtar i ""

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 14.7.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.48 Akti që i përket :

KËRKUES: BASHKIA TIRANË, e përfaqësuar nga zoti Albert Brojka, kryetar.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga zoti Viktor Gumi, këshilltar juridik i Kryetarit të Kuvendit.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga zoti Ilir Panda, Ministër i Drejtësisë.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 39 të Ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal" dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.234, datë 22.5.1999 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993 "Për masat për zbatimin e Ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". (Nenet 13, 109, 131 pika "c" dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë)

Pala kërkuese ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 39 të ligjit si dhe të vendimit:

- Neni 39 i Ligjit nr.7572, datë 10.6.1992, që parashikon se sekretari i Këshillit të Bashkisë emërohet e shkarkohet nga Këshilli i Ministrave vjen në kundërshtim me parimet kushtetuese të decentralizimit të pushtetit e të autonomisë vendore;

- Duke i dhënë të drejtë sekretarit të Bashkisë të propozojë përbërjen e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, preket rëndë barazia e anëtarëve brenda organit të pushtetit lokal dhe vihet sekretari në pozitë të privilegjuar në raport me kryetarin e Bashkisë që është i zgjedhur nga populli;

- Me ndryshimet e reja, kompetenca e emërimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i mohohet Këshillit të Bashkisë që është organ i zgjedhur dhe i kalon Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve që është organ qendror i administratës shtetërore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e palës kërkuese, të përfaqësuesve të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Në nenin 39 të Ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal", është përcaktuar se sekretari i Këshillit të Komunës ose Bashkisë, emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave ndërsa në nenin 40, janë përcaktuar kompetencat kryesore të tij. Këto kompetenca kanë të bëjnë me marrjen e masave për mbledhjen e këshillit, komunikimin e aktave të nxjerra, njoftimin e opinionit publik për rregullat me interes të përgjithshëm, me kujdesin për

veprimtarinë e sekretarisë etj. Duke qenë se natyra e këtyre kompetencave është tekniko-administrative, ato nuk pengojnë organet e pushtetit vendor të ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas parimeve të Kushtetutës.

Respektimi i parimeve kushtetuese të autonomisë vendore e të decentralizimit, përcaktohet në radhë të parë nga kompetencat dhe veprimtaria e organeve. Meqënëse kompetencat e sekretarit të Këshillit të Bashkisë të parashikuara në Ligjin nr.7572, datë 10.6.1992 nuk janë antikushtetuese, kërkesa nuk mund të pranohet. Nëse atij i janë dhënë kompetenca të tjera me akte të veçanta që kanë hyrë në fuqi, këto nuk janë objekt i kërkesës dhe për rrjedhojë nuk janë objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë.

Përsa i përket pretendimit tjetër të parashtruar në kërkesë për antikushtetutshmërinë e vendimit të Këshillit të Ministrave nr,234, datë 22.5.1999 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993 "Për masat për zbatimin e Ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", konstatojmë se ky vendim nuk është botuar ende në Fletoren Zyrtare dhe, në kuptim të nenit 117 të Kushtetutës, nuk ka marrë fuqi juridike. Prandaj në zbatim të kësaj norme dhe në vijim të qëndrimit të mëparshëm të shprehur për këtë problem në vendimin e saj nr.47, datë 7.7.1999 Gjykata Kushtetuese e konsideron çështjen në shqyrtim për këtë pikë si pa objekt.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/a, c dhe 134/e të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumice votash,

V E N D O S I

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Sipas nenit 13 të Kushtetutës qeverisja vendore, ku përfshihet edhe bashkia e komuna, ngrihet mbi bazën e parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. Karakteristikat e decentralizimit dhe të autonomisë vendore janë ndër të tjera se ka një hapësirë lirije në lidhje me pushtetin qendror që nuk është absolute sepse duhet të veprojë në bazë të kuadrit kushtetues dhe ligjor të shtetit, por në fusha të caktuara të kompetencës së tyre mund të veprojnë sipas vullnetit të tyre pa patur të drejtë pushteti qendror të ndërhyjë. Për të realizuar aktivitetin administrativ Bashkia e komuna, si njësitë e tjera vendore, disponojnë aparatet administrative që janë nën vartësinë e tyre dhe që nuk varen nga qendra.

Sipas nenit 34 të Ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal", në kompetencat e kryetarit të bashkisë e të komunës përfshihet sipas pikës 18 emërimi dhe shkarkimi i personelit të administratës. Edhe sekretari i këshillit të komunës ose bashkisë bën pjesë në personelin e administratës. Kompetencat kryesore të sekretarit janë thjeshtë ato të zakonshmet që përmend neni 40 i ligjit. Ndër këto rrethana emërimi i tij dhe shkarkimi jo nga kryetari, por nga Këshilli i Ministrave formon krejt një cënim të parimit të autonomisë vendore që parashikon neni 13 i Kushtetutës. Shprehja e nenit 40 se sekretari ka këto kompetenca kryesore, do të thotë se kryesoret janë ato që përmend neni 40.

Eshtë e vërtetë se neni 40 në fund përmban se sekretari kryen gjithashtu edhe detyra të tjera të caktuara me ligj ose që i caktohen atij nga këshilli apo kryetari i komunës ose bashkisë, por cilatdo qofshin ato në radhë të parë nuk mund të jenë detyra kryesore sepse nuk e përmend ligji dhe detyrat e tjera nuk mund t'i njohin sekretarit cilësi të veçanta që të emërohet e të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave.

Në vendimin e nr.2, datë 25.1.1999 të kësaj Gjykate si për pranimin si antikushtetues të

paragrafit të fundit të nenit 14 dhe nenit 23 paragrafet 1 e 2 të Ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën” pranohet se: “Organet e pushtetit lokal në bazë të Ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, emërojnë dhe shkarkojnë personelin e administratës së këtyre organeve dhe si të tilla janë ato që duhet të vendosin për mënyrën e emërimit apo të shkarkimit të përgjegjësit të seksionit të urbanistikës apo të drejtorit të urbanistikës për Tiranën”.

Pra pranohet se janë organet e pushtetit lokal që duhet të vendosin për emërimin apo shkarkimin e personelit të administratës së tyre kështu që nuk ka asnjë shkak të veçantë që sekretari i bashkisë apo komunës që është personel administratëv të mos zgjidhet nga organet e pushtetit lokal.

Prandaj kërkesa për shfuqizimin e nenit 39 si antikushtetues është e bazuar dhe duhej pranuar.

A N Ë T A R I
H. Dakli

MENDIMI I PAKICËS

Është e vërtetë që sekretari i Bashkisë nuk ushtron kompetenca që kanë të bëjnë me autonominë vendore, pra ai nuk është pjesë e pushtetit vendor, por është pjesë e aparatit administrativ të pushtetit vendor që ndihmon për ushtrimin e atij pushteti.

Në kompetencat e sekretarit të Bashkisë ka edhe të tilla si komunikimi e parashtrimi autoriteteve e personave të interesuar të akteve të këshillit apo kryetarit, marrja e masave që opinioni publik të njoftohet për vendimet dhe rregullat në interes të përgjithshëm etj. Këto kanë interes shtetëror sepse i shërbejnë zbatimit të njëjtë e korrekt të ligjeve dhe ndihmojnë në kontrollin shtetëror për ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit vendor. Por të gjitha këto nuk justifikojnë që sekretari i Bashkisë të emërohet nga organi qendror. Ky është në radhë të parë pjesë e aparatit administrativ të organeve të pushtetit lokal dhe si i tillë për emërimin tij duhet të jetë miratimi i këtyre organeve.

Sipas mendimit tim administratës qendrore i besohen ato detyra që kanë karakter kombëtar, ekzekutimi i të cilave, në kuptim të ligjit, nuk mund t’i delegohen vetëm nivelit lokal ndërsa detyrat e tjera dhe pikërisht ato që kanë të bëjnë me lidhjet midis shtetit dhe organeve lokale duhet t’i besohen administratës së këtyre të fundit.

Neni 39 i Ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, që përcakton se sekretari i Këshillit të Komunës ose Bashkisë emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, nuk duhet të interpretohet se ka të bëjë vetëm me emërtesën. Ai parashikon njëkohësisht edhe kompetencën që i është dhënë organit qendror në raport me organin e pushtetit vendor. Duke qenë edhe kompetencë dhe duke mënjanuar fare pëlqimin e organeve të pushtetit lokal për emërimin e punonjësit të aparatit të tyre administrativ, cënohet parimi i decentralizimit të pushtetit i parashikuar në nenin 13 të Kushtetutës.

A N Ë T A R I
K. Puto

Tiranë, më 28.9.1999

Nr. 48 i regjistrit themeltar.
Nr. 53 i vendimit.